FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për përdoruesin

LAMOTRIGINE

Tableta – 50 mg, 200 mg
(Lamotriginë)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.
- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Lamotrigine dhe përse përdoret
2. Çfarë duhet të dini përpara se të merrni Lamotrigine
3. Si ta merrni Lamotrigine
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Lamotrigine
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË LAMOTRIGINE DHE PËRSE PËRDORET

Lamotrigine bën pjesë në grupin e barnave të quajtura *anti-epileptikë*.
Përdoret për trajtimin e dy gjendjeve - epilepsisë dhe çrregullimit bipolar.
Lamotrigine trajton epilepsinë duke bllokuar sinjalet në tru që shkaktojnë kriza epileptike.
- Për të rriturit dhe fëmijët e moshës 13 vjeç e sipër, Lamotrigine mund të përdoret vetëm ose e kombinuar me barna të tjera, për trajtimin e epilepsisë. Lamotrigine gjithashtu mund të përdoret me barna të tjera për trajtimin e krizave që ndodhin në një gjendje tjetër që quhet sindromi Lennox-Gastaut.
- Për fëmijët e moshës mes 2 dhe 12 vjeç, Lamotrigine mund të përdoret me barna të tjera, për të trajtuar këto gjendje. Ajo mund të përdoret e vetme për trajtimin e një lloj epilepsie të quajtur kriza tipike të mungesës.

Lamotrigine gjithashtu trajton çrregullimet bipolare.
Njerëzit me çrregullim bipolar (nganjëherë i quajtur *depresion maniakal*) kanë lëvizje ekstreme të humorit, me periudha manie (eksitim ose eufori) e alternuar me periudha depresioni (mërzitje e thellë apo dëshpërim). Për të rriturit e moshës 18 vjeç e sipër, Lamotrigine mund të përdoret e vetme ose e kombinuar me barna të tjera, për të parandaluar periudhat e depresionit që ndodhin në çrregullimin bipolar. Nuk dihet ende se si Lamotrigine vepron në tru për ta dhënë këtë efekt.

2. ÇFARË DUHET TË DINI PËRPARA SE TË MERRNI LAMOTRIGINE

Mos merrni Lamotrigine:
- në qoftë se keni alergji ndaj lamotriginës apo përbërësve të tjerë të këtij bari (të renditur në pikën 6).

Nëse kjo vlen për ju, tregojini mjekut tuaj dhe mos merrni Lamotrigine.

Tregoni kujdes të veçantë me Lamotrigine
Këshillohuni me mjekun ose farmacistin tuaj para se të merrni Lamotrigine.
Mjeku juaj duhet të dijë para se të merrni Lamotrigine në qoftë se:
- keni ndonjë problem me veshkat
- keni zhvilluar ndonjëherë skuqje të lëkurës pas marrjes së lamotriginës apo barnave të tjera për çrregullim bipolar apo epilepsi
- jeni tashmë duke marrë barna që përmbajnë lamotriginë.

Nëse ndonjë nga këto vlen për ju, tregojini mjekut tuaj, i cili mund të vendosë për të ulur dozën, ose që Lamotrigine nuk është e përshtatshme për ju.

Informacione të rëndësishme për reaksionet potencialisht serioze
Skuqje të lëkurës potencialisht të rrezikshme për jetën (sindromi Stevens-Johnson, nekroliza epidermale toksike ose reaksione të barit me eozinofili dhe simptoma sistemike (DRESS)) janë raportuar me përdorimin e lamotriginës, duke u paraqitur fillimisht si njolla të kuqërremta ose njolla rrethore, shpesh me flluska qendrore, në trung.
Shenja të tjera identifikuese përfshijnë ulçerat në gojë, fyt, hundë, organe gjenitale dhe konjunktivit (skuqje dhe enjtje e syve).
Këto skuqje të lëkurës potencialisht të rrezikshme për jetën janë shpesh të shoqëruara me simptoma si të gripit. Skuqja mund të përparojë në flluska të përhapura ose rrjepje të lëkurës.
Sindroma DRESS shfaqet fillimisht si simptomat e gripit dhe me skuqje në fytyrë, më pas me skuqje të përhapur dhe temperaturë të lartë, nivele të rritura të enzimave hepatike në analizat e gjakut dhe rritje të një lloji të qelizave të bardha të gjakut (eozinofili) dhe nyje limfatike të zmadhuara.
Rreziku më i lartë për shfaqjen e reaksioneve të rënda të lëkurës është brenda javëve të para të trajtimit.
Nëse keni zhvilluar sindromën Stevens-Johnson, nekrolizë epidermale toksike apo DRESS nga përdorimi i Lamotrigine, nuk duhet të ri-filloni Lamotrigine asnjëherë.
Nëse zhvilloni skuqje apo simptoma të tilla të lëkurës, kërkoni menjëherë këshillën e mjekut dhe tregoni që jeni duke marrë këtë bar.

Mendimet për të dëmtuar veten apo vetëvrasje
Barnat anti-epileptike janë përdorur për të trajtuar disa gjendje, përfshirë epilepsinë dhe çrregullime bipolare. Njerëzit me çrregullim bipolar nganjëherë mund të kenë mendime për të dëmtuar vetveten ose për të bërë vetëvrasje.
Nëse keni çrregullim bipolar, mund të ketë shumë mundësi të mendoni kështu:
- në fillim të trajtimit
- në qoftë se keni patur më parë mendime për të dëmtuar vetveten ose për vetëvrasje
- në qoftë se jeni nën 25 vjeç.

Nëse keni mendime apo përjetime shqetësuese, ose në qoftë se vëreni se ndiheni më keq ose zhvilloni simptoma të reja ndërhohë që jeni duke marrë Lamotrigine, pyesni mjekun sa më shpejt të jetë e mundur ose shkoni në spitalin më të afërt për ndihmë.
Një numër i vogël i njerëzve të trajtuar me anti-epileptikë të tillë si Lamotrigine gjithashtu kanë pasur mendime për të dëmtuar ose vrarë veten. Kurdo që të keni mendime të tilla, menjëherë kontaktoni mjekun tuaj.

Nëse jeni duke marrë Lamotrigine për epilepsinë
Nganjëherë, krizat në disa lloje të epilepsisë mund të bëhen më të rënda apo mund të ndodhin më shpesh ndërkohë që jeni duke marrë Lamotrigine. Disa pacientë mund të përjetojnë kriza të rënda, që mund të shkaktojnë probleme serioze shëndetësore. Nëse krizat ndodhin më shpesh, ose në qoftë se përjetoni kriza të rënda ndërsa jeni duke marrë Lamotrigine, takoni mjekun sa më shpejt të jetë e mundur.
Lamotrigine nuk duhet të jepet tek njerëzit e moshës nën 18 vjeç për trajtimin e çrregullimit bipolar. Barnat për trajtimin e depresionit dhe problemeve të tjera të shëndetit mendor rrisin rrezikun e mendimeve dhe sjelljen për vetëvrasje të fëmijëve dhe adoleshentëve të moshës nën 18 vjeç.

Marrja e barnave të tjera
Tregojini mjekut ose farmacistit tuaj nëse jeni duke marrë/përdorur, keni marrë/përdorur kohët e fundit ose mund të merrni/përdorni ndonjë bar tjetër.
Mjeku juaj duhet të dijë nëse jeni duke marrë barna të tjera për trajtimin e epilepsisë ose të problemeve të shëndetit mendor. Kjo është për t'u siguruar që jeni duke marrë doza të sakta të Lamotrigine. Këto barna përfshijnë:
- oksarbazepinë, felbamat, gabapentin, levetiracetam, pregabalin, topiramat ose zonisamid, të përdorura për trajtimin e epilepsisë
- litium ose olanzapinë, të përdorura për trajtimin e problemeve të shëndetit mendor
- bupropion, i përdorur për trajtimin e problemeve të shëndetit mendor apo për ndërprerjen e pirjes së duhanit.

Tregojini mjekut tuaj nëse jeni duke marrë ndonjë nga këto.
Disa barna ndërveprojnë me Lamotrigine ose shtojnë mundësinë për efekte anësore. Këto përfshijnë:
- valproatin, i përdorur për trajtimin e epilepsisë dhe problemeve të shëndetit mendor
- karbamazepinën, e përdorur për trajtimin e epilepsisë dhe problemeve të shëndetit mendor
- fenitoinën, primidonin ose fenobarbitalin, të përdorur për trajtimin e epilepsisë
- risperidonin, i përdorur për trajtimin e problemeve të shëndetit mendor
- rifampicinën, e cila është një antibiotik
- barnat që përdoren për trajtimin e infeksionit të virusit të imunodefiçiencës njerëzore (HIV) (kombinim i lopinavir dhe ritonavir ose atazanavir dhe ritonavir)
- kontraceptivët hormonalë, si Pilula *(shih më poshtë)*.

Tregojini mjekut tuaj nëse jeni duke marrë ndonjë nga këto, ose në qoftë se filloni ose ndërprisni marrjen e ndonjërit.

Kontraceptivët hormonalë (të tillë si Pilula) mund të ndikojnë në mënyrën e veprimit të Lamotrigine
Mjeku juaj mund t' ju rekomandojë që të përdorni një lloj të veçantë të kontraceptivëve hormonalë, ose një tjetër metodë të kontracepsionit, të tillë si prezervativ, diafragmë ose spirale. Nëse jeni duke përdorur kontraceptivë hormonalë si Pilula, mjeku juaj mund të marrë mostrat e gjakut tuaj për të kontrolluar nivelin e lamotriginës. Nëse jeni duke përdorur kontraceptivë hormonalë ose në qoftë se keni ndërmend të filloni të përdorni ndonjë, konsultohuni me mjekun tuaj, i cili do të diskutojë me ju metodat e përshtatshme të kontracepsionit.
Lamotrigine gjithashtu mund të ndikojë në mënyrën e veprimit të kontraceptivëve hormonalë, edhe pse nuk ka gjasa për t'i bërë ata më pak efikasë. Nëse jeni duke përdorur një kontraceptiv hormonal, dhe vini re ndonjë ndryshim në menstruacione, të tilla si gjakrrjedhje në mes të ciklit apo njolla ndërmjet periodave, tregojini mjekut tuaj. Këto mund të jenë shenja që Lamotrigine po ndikon në mënyrën e veprimit të kontraceptivëve.

Shtatzënia, ushqimi me gji dhe fertiliteti
Në qoftë se jeni shtatzënë apo ushqeni foshnjen me qumësht gjiri, dyshoni se jeni shtatzënë ose po planifikoni të mbeteni shtatzënë. pyesni mjekun ose farmacistin tuaj për këshilla para se të merrni këtë bar.
Nuk duhet të ndërprisni trajtimin pa e diskutuar këtë me mjekun tuaj. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në qoftë se jeni me epilepsi.
Rrezik i shtuar i defekteve të lindura mund të ekzistojë tek foshnjat, nënat e të cilëve kanë marrë Lamotrigine gjatë shtatzënisë. Këto defekte përfshijnë: buzë të çarë apo qiellzë të çarë. Mjeku mund t'ju këshillojë të merrni acid folik shtesë në qoftë se jeni duke planifikuar të mbeteni shtatzënë dhe gjatë kohës që jeni shtatzënë.
Shtatzënia mund gjithashtu të ndryshojë efektivitetin e Lamotrigine, kështu që mund të keni nevojë për analiza të gjakut dhe doza e Lamotrigine mund të ndryshohet.
Përbërësi aktiv i Lamotrigine kalon në qumështin e gjirit dhe mund të ndikojë tek foshnja. Mjeku do t'ju informojë mbi rreziqet dhe përfitimet e të ushqyerit me gji ndërsa jeni duke marrë Lamotrigine, dhe do t'ju kontrollojë foshnjen kohë pas kohe në qoftë se vendosni ta ushqeni me gji.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive
Lamotrigine mund të shkaktojë marramendje dhe vizion të dyfishtë. Mos drejtoni automjetin ose përdorni makineri nëse nuk jeni i sigurt se si ajo ndikon tek ju.
Nëse keni epilepsi, bisedoni me mjekun tuaj mbi drejtimin e automjetit dhe përdorimin e makinerive.

Lamotrigine përmban laktozë.
Lamotrigine tableta përmban sasi të vogla të sheqerit të quajtur laktozë. Nëse keni intolerancë nga laktoza ose ndonjë sheqer tjetër, kontaktoni mjekun tuaj, dhe mos merrni Lamotrigine.

3. SI TA MERRNI LAMOTRIGINE

Gjithmonë merreni këtë bar sipas këshillës së mjekut. Në qoftë se nuk jeni i sigurt kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj.

Sa Lamotrigine duhet marrë
Mund të duhet kohë për të përcaktuar dozën e përshtatshme të lamotriginës.
Doza e marrë do të varet nga:
- mosha
- nëse jeni duke marrë Lamotrigine me barna të tjera
- nëse keni ndonjë problem të veshkave ose të mëlçisë.

Mjeku do të përshkruajë në fillim një dozë të ulët, dhe gradualisht do të rrisë dozën gjatë disa javëve derisa të arrijë në një dozë të përshtatshme për ju (e quajtur doza efektive). Asnjëherë mos merrni më shumë Lamotrigine se sasia që ju ka rekomanduar mjeku.
Doza e zakonshme efektive e Lamotrigine për të rriturit dhe fëmijët e moshës 13 vjeç e e sipër është ndërmjet 100 mg dhe 400 mg çdo ditë.
Për fëmijët e moshës 2 deri në 12 vjeç, doza efektive varet nga pesha trupore e tyre zakonisht, kjo është në mes 1 mg dhe 15 mg për kilogram peshë të fëmijës, deri në një maksimum prej 400 mg në ditë.
Lamotrigine nuk rekomandohet për fëmijët e moshës nën 2 vjeç.

Si të merrni dozën e Lamotrigine
Merrni dozën e Lamotrigine një herë ose dy herë në ditë, sipas këshillës së mjekut. Ju mund ta merrni atë me ose pa ushqim.
Mjeku juaj mund t'ju këshillojë për të filluar ose ndërprerë marrjen e barnave të tjera, në varësi të gjendjes që trajtoni dhe mënyrës se si i përgjigjeni trajtimit.
- Gëlltiteni të plotë tabletën. Mos e ndani, përtypni apo shtypni.
- Gjithmonë merrni dozën e plotë që mjeku juaj ka përshkruar. Mos merrni vetëm një pjesë të tabletës.

Në qoftë se keni marrë më shumë Lamotrigine
Kontaktoni mjekun ose farmacistin menjëherë. Në qoftë se është e mundur, tregojuni atyre kutinë e Lamotrigine.
Kush ka marrë shumë Lamotrigine mund të ketë ndonjë nga këto simptoma:
- lëvizje të shpejta, të pakontrolluara të syrit (nistagmus)
- ngathtësi dhe mungesë koordinimi, që ndikon në ekuilibër (ataksi)
- humbje e vetëdijes ose gjendje kome.

Në qoftë se keni harruar të merrni Lamotrigine
Mos merrni një dozë të dyfishtë për të kompensuar dozën e harruar.
Pyesni mjekun tuaj për këshilla se si të filloni ta merrni atë përsëri. Është e rëndësishme që ta bëni këtë.
Mos ndërprisni marrjen e Lamotrigine pa u këshilluar.
Lamotrigine duhet të merret për aq kohë sa mjeku jua rekomandon. Mos e ndërprisni përveç nëse mjeku ju këshillon.

Nëse jeni duke marrë Lamotrigine për epilepsi
Për të ndërprerë marrjen e Lamotrigine është e rëndësishme që doza të reduktohet gradualisht, afërsisht përgjatë 2 javëve. Nëse papritur ndërprisni marrjen e Lamotrigine, epilepsia mund të kthehet ose të përkeqësohet.

Nëse jeni duke marrë Lamotrigine për çrregullimin bipolar
Lamotrigine mund të kërkojë kohë për të vepruar, kështu që nuk ka gjasa të ndiheni mirë menjëherë. Në qoftë se ndërprisni marrjen e Lamotrigine, doza juaj nuk do të duhet të reduktohet gradualisht. Por gjithsesi duhet të bisedoni me mjekun tuaj paraprakisht në qoftë se doni të ndërprisni marrjen e Lamotrigine.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjitha barnat e tjera, ky bar mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston.
Reaksionet potencialisht serioze: kërkoni menjëherë ndihmën e mjekut.
Një numër i vogël i personave që marrin lamotriginë shfaqin reaksion alergjik ose reaksion potencialisht serioz të lëkurës, i cili mund të zhvillohet në probleme më serioze në qoftë se nuk trajtohet.
Këto simptoma është më e mundur të ndodhin gjatë muajve të parë të trajtimit me lamotriginë, veçanërisht në qoftë se doza fillestare është shumë e lartë ose nëse doza rritet shumë shpejt, ose në qoftë se Lamotrigine është marrë me një tjetër bar të quajtur valproat. Disa nga simptomat janë më të zakonshme tek fëmijët, kështu që prindërit duhet të jenë veçanërisht të kujdesshëm.
Simptomat e këtyre reaksioneve përfshijnë:
- skuqje të lëkurës, të cilat mund të përparojnë në reaksione të rënda të lëkurës duke përfshirë skuqje me flluska të përhapura dhe rrjepje të lëkurës, veçanërisht shfaqen përreth gojës, hundës, syve dhe organeve gjenitale (sindromi Stevens-Johnson), rrjepje e përhapur e lëkurës (më shumë se 30% e sipërfaqes së trupit – nekrolizë epidermale toksike) ose reaksion ndaj barit me eozinofili dhe simptoma sistemike (DRESS)
- lëndim i gojës apo syve
- temperaturë e lartë (ethe), simptoma të ngjashme me gripin ose përgjumje
- enjtje rreth fytyrës, ose gjendra të enjtura në qafë, sqetull ose ije
- gjakrrjedhje e papritur ose mavijosje, apo ngjyrosje në blu e gishtërinjve
- dhimbje fyti, ose më shumë infeksione (të tilla si ftohjet) se sa zakonisht.

Në shumë raste, këto simptoma do të jenë shenja të efekteve anësore më pak serioze, por duhet të jeni në dijeni se ato janë potencialisht serioze dhe mund të zhvillohen probleme më të rënda, të tilla si insufiçiencë e organeve në qoftë se nuk trajtohen. Nëse vëreni ndonjë nga këto simptoma kontaktoni mjekun menjëherë. Mjeku mund t'ju kërkojë të bëni analizat e mëlçisë, veshkave apo gjakut, dhe mund t'ju rekomandojë ndërprerjen e marrjes së Lamotrigine.

Efekte anësore shumë të zakonshme (prekin më shumë se 1 përdorues në 10):
- dhimbje koke
- ndjenjë marremendjeje
- ndjenjë përgjumjeje
- ngathtësi dhe mungesë koordinimi (ataksi)
- shikim i gjërave dyshe apo shikim i paqartë
- ndjesi përzierjeje ose të vjella
- skuqje të lëkurës.

Efekte anësore të zakonshme (prekin 1 deri në 10 përdorues në 100):
- agresion ose irritim
- lëvizje e shpejtë, e pakontrolluar e syrit (nistagmus)
- dridhje ose tremor
- vështirësi për të fjetur
- diarre
- tharje goje
- ndjesi lodhjeje
- dhimbje shpine apo e kyçeve, ose diku tjetër.

Efekte anësore të rralla (prekin 1 deri në 10 përdorues në 1,000):
- kruajtje e syve, me qepalla të acaruara dhe me rrjedhje (konjunktivit)
- janë raportuar skuqje të lëkurës potencialisht të rrezikshme për jetën (sindrom Stevens-Johnson) (shih pikën 2)

Efekte anësore shumë të rralla (prekin 1 deri në 10 përdorues në 10,000):
- haluçinacione ('shikimi' ose 'dëgjimi' i gjërave që nuk janë me të vërtetë atje)
- konfuzion ose axhitim
- ndjesi pasigurie apo paqëndrueshmërie gjatë lëvizjes
- lëvizje të pakontrolluara të trupit *(tike)*, spazma të pakontrolluara të muskujve që prekin sytë, kokën dhe toraksin *(koreoatetozë)*, ose lëvizje të tjera të pazakonta të trupit të tilla si hedhje, dridhje ose ngurtësim
- janë raportuar skuqje të lëkurës potencialisht të rrezikshme për jetën (nekrolizë epidermale toksike) (shih pikën 2)
- tek personat të cilët tashmë kanë epilepsi, krizat ndodhin më shpesh
- ndryshime në funksionin e mëlçisë, të cilat shfaqen në analizat e gjakut, ose insufiçiencë e mëlçisë
- ndryshime të cilat mund të shfaqen në analizat e gjakut - duke përfshirë numrin e reduktuar të qelizave të kuqe të gjakut *(anemi)*, numrin e reduktuar të qelizave të bardha të gjakut *(leukopeni, neutropeni, agranulocitozë)*, numrin e reduktuar të trombociteve *(trombocitopeni)*, numrin e reduktuar të të gjitha këtyre llojeve të qelizave *(pancitopeni)*, dhe çrregullim të palcës së kockave të quajtur *anemi aplastike*
- çrregullim i rëndë i koagulimit të gjakut, i cili mund të shkaktojë gjakrrjedhje të papritur ose mavijosje *(koagulim intravaskular i përhapur)*
- temperaturë e lartë *(ethe)*
- enjtje rreth fytyrës *(edema)* ose gjendra të enjtura në qafë, sqetull dhe ije *(limfadenopati)*
- tek personat të cilët tashmë kanë sëmundjen e Parkinsonit, përkeqësim i simptomave.

Efekte anësore të panjohura (frekuenca nuk mund të vlerësohet nga të dhënat në dispozicion):
- DRESS
- grup simptomash së bashku duke përfshirë: ethe, të përziera, të vjella, dhimbje koke, qafë e ngurtësuar dhe ndjeshmëri ekstreme ndaj dritës së fortë;
  kjo mund të shkaktohet nga inflamacioni i membranave që mbulojnë trurin dhe palcën kurrizore (meningjit)
- ka pasur raportime për çrregullime të kockave duke përfshirë osteopeninë dhe osteoporozën (hollim i kockave) dhe fraktura. Kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj nëse jeni duke marrë barna antiepileptikë për kohë të gjatë, keni histori të osteoporozës, ose merrni steroidë.

5. SI TA RUANI LAMOTRIGINE

Mbajeni larg fëmijëve!
Mos e përdorni kërë bar pas datës së skadencës e cila është e shënuar në blister ose paketim.
Ky bar nuk kërkon kushte specifike të ruajtjes.

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Lamotrigine tableta
Lënda vepruese është lamotriginë.
Një tabletë përmban 50 mg ose 200 mg lamotriginë.
Përbërësit e tjerë janë: laktozë monohidrat, celulozë mikrokristalore, povidon K30, oksid hekuri i verdhë (E172), glikolat natriumi i amidonit (tipi A), stearat magnezi, talk, dioksid silici koloidal.

Përmbajtja e paketimit
Lamotrigine 50 mg: kuti me 50 tableta.
Lamotrigine 200 mg: kuti me 50 tableta.

Shpjegues i ikonave ilustruese për paketim:

Sipas recetës së mjekut.

Përmbajtja. Kujdes.

Forma e tabletës.

Mbajtësi i Autorizimit për Tregtim (MAT) dhe Prodhuesi:

PROFARMA Sh.a.
Rruga "Myslym Keta"
Tel.: 00355 4 23 89 602
Tiranë - SHQIPËRI

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Dhjetor 2014.

SPECIFICATION

CROPING AREA 15 X 25 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible. If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.